

**VENDIM**  
**Nr. 1060, datë 14.12.2013**  
**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE TË**  
**PUNËDHËNËSVE DHE TË PUNËMARRËSVE NË KËSHILLIN KOMBËTAR TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 200 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve në Këshillin Kombëtar të Punës janë, si më poshtë vijon:

A. Për organizatat e punëdhënësve:

- |   |                       |
|---|-----------------------|
| a) Biznesalbania  | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| b) Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB)                              | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| c) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH)                       | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ç) Shoqata Shqiptare e Turizmit (SHSHT)                             | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| d) Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pijeve (SHBUP)                     | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| dh) Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit (SHSHTI)      | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| e) Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve Shqiptarë (BI&ISH) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ë) Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve (DHKPV)                 | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| f) Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS)                             | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| g) Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH)                          | 1 anëtar, 1 kandidat. |

B. Për organizatat e punëmarrësve:

- |   |                       |
|---|-----------------------|
| a) Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH)                     | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| b) Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH)                          | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| c) Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë (SPMSH)                       | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ç) Federata Sindikale e Arsimit dhe Shkencës (FSASH)                            | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| d) Sindikata Autonome e Ushqim, Tregtisë, Turizmit (SAUTT)                      | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| dh) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH)                              | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| e) Federata e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FPISH)                    | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ë) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor (FSPSHSH)      | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| f) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Artizanatit dhe Manufakturës (FSPAM) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| g) Federata e Sindikatave të Shërbimeve Financiare, Tregtisë, Bankës e Turizmit | 1 anëtar, 1 kandidat. |

2. Emërimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, me propozimin e organizatave përkatëse të punëmarrësve dhe punëdhënësve.

3. Vendimi nr. 132, datë 24.2.2010 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama